




REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna Drenas
Zyra e Kryetarit
Drenas, më 06.04.2018



Nga: Kryetari i Komunës së Drenasit **z. Ramiz Lladrovci**

Për: Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal

[Signature]



LËNDA: Dërgimi i akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më datën 29.03.2018

1. Vendim për shpalljen e Pandeli Majko, “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasi
2. Vendim për shpalljen e Walburga Habsburg Douglas, “Qytetare Nderi” e Komunës së Drenasit
3. Vendim për shfuqizimin e vendimit të kuvendit të Komunës nr.463-34434 të dt.20.06.2016, në ngastrën kadastrale 726/15 në zonën kadastrale në Drenas, që ishin dhënë në shfrytëzim kompanisë “Valdrini”shpk
4. Vendim për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës 12 nr.353-12312 të dt.04.03.2015, në zonën kadastrale Korroticë e Ulet
5. Vendim për shfuqizimin e vendimit të kuvendit të komunës 12 nr.351-183 të dates 31.12.2004, në ngastrën kadastrale 144/2 në zonën kadastrale në Polluzhë, që ishin dhënë në shfrytëzim kompanisë “Hitchenergy Kosova” me pronar Ali Kastratin nga Polluzha
6. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të komunës 12 nr.463-16568 të datës 25.03.2015, në ngastrën kadastrale 295/1 në zonën kadastrale në Sankoc, që ishte dhënë në shfrytëzim Rashit Rashiti nga Sankoci

7. Vendim për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2017
8. Vendim për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për ndërmarrjen publike “Pastrimi”
9. Vendimi i komisionit për zgjedhjen e këshillave neper fshatra dhe vendbanimet urbane
10. Vendim për emërimin e bibliotekës së qytetit të Drenasit me emrin “Ymer Elshani”
11. Vendimi për zëvendësimin e anëtarit të Komitetit për Politik dhe Financa,
12. Vendimi për zëvendësimin e anëtarit të Komitetit për Komunitete
13. Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të Komunës
14. Vendim për ndryshim plotësimi e rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha
15. Vendimi për emërtimin e Shtëpisë së Kulturës “Rifat Kukaj”
16. Vendim për emërtimin e palestrës sportive “Hysni Jetullahu”

Drenas
06.04.2018



**Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit(Gllogoc)**

Kuvendi i Komunës
12 Nr.060-19582 dt.06.04.2018



Nga :Kryesuesi i Kuvendit të Komunës- z.Labir Hoti

Për: Kryetarin e Komunës z.Ramiz Lladrovci

LËNDA: Dërgimi i akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më dt : 29.03.2018

1. Vendim për shpalljen e Pandeli Majko, “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit
2. Vendim për shpalljen e Walburga Habsburg Douglas, “Qytetare Nderi” e Komunës së Drenasit
3. Vendim për shfuqizimin e vendimit të kuvendit të Komunës nr.463-34434 të dt.20.06.2016,në ngastren kadastrale 726/15 në zonen kadastrale në Drenas,që ishin dhënë në shfytëzim kompanisë “Valëdrini”shpk
4. Vendim për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës 12 nr.353-12312 të dt.04.03.2015,në zonen kadastrale Korroticë e ulet
5. Vendim për shfuqizimin e vendimit të kuvendit të komunës 12 nr.351-183 të dates 31.12.2004, në ngastren kadastrale 144/2 në zonen kadastrale në Polluzhë, që I ishin dhënë në shfytëzim kompanisë “Hitchenergy Kosova” me pronar Ali Kastratin nga Polluzha
6. Vendim per shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të komunës 12 nr.463-16568 të dates 25.03.2015, ne ngastren kadastrale 295/1 në zonen kadastrale në sankoc,që ishte dhënë në shfytëzim Rashit Rashiti nga Sankoci
7. Vendim per bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2017

8. Vendim për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për ndermarrjen publike "Pastrimi"
9. Vendimi i komisionit për zgjedhjen e këshillave nëpër fshatra dhe vendbanimet urbane
10. Vendim për emrimin e bibliotekës së qytetit të Drenasit me emrin "Ymer Elshani"
11. Vendimi për zëvendësimin e antarit të Komitetit për Politikë dhe Financa,
12. Vendimi për zëvendësimin e antarit të Komitetit për Komunitete
13. Ndryshimin dhe plotësimin e statutit të Komunës
14. Ndryshim i plotësimit të rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoka
15. Vendimi për emërtimin e Shtëpise së Kulturës "Rifat Kukaj"
16. Vendimi për emërtimin e palestrës sportive "Hysni Jetullau"

Drenas,
05.04.2018



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA DRENAS

Kuvendi i Komunës

Nr. 030-19587 datë 06.04.2018

Në bazë të nenit 11, 12, nenit 40 pikë 40.2 shkronja h, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 3, pika 3.5 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës në mbledhje e radhës të mbajtur më datë 29.03.2018, aprovoi këtë:

**VENDIM
PËR SHPALLJEN E PANDELI MAJKO QYTETAR NDERI I KOMUNËS SË
DRENASIT**

Neni 1

Me këtë Vendim, Ish Kryeministri Shqiptar, z. Pandeli Majko, burrështetas, dijetar, inxhinier i mekanikes, jurist, politikan shqiptar, shpallet “QYTETAR NDERI I KOMUNËS SË DRENASIT”.

Neni 2

AUTORIZOHET kryetari i Komunës së Drenasit, z. Ramiz Lladrovci, që të nënshkruaj Pllakatin përkatës që do të hartohet për qëllimin e cekur në nenin I të këtij Vendimi.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës së Drenasit.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohet: Asambleja e Komunës, MAPL e Republikës së Kosovës.

Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labiriot Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
Kuvendi i Komunës
812 Nr 030-19589 datë 06.04.2018

Në bazë të nenit 11, 12, nenit 40 pikë 40.2 shkronja h, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 3, pikë 3.5 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës në mbledhje e radhës të mbajtur më datë 29.03.2018, aprovoi këtë:

VENDIM
PËR SHPALLJEN E ËALBURGA HABSBURG DOUGLAS QYTETARE NDERI E
KOMUNËS SË DRENASIT

Neni 1

Me këtë Vendim, Kontesha e Komunës Skänninge të Suedisë, znj. Walburga Habsburg Douglas, anëtare e familjes mbretërore të Austrisë dhe të Suedisë, shpallet **“QYTETARE NDERI E KOMUNËS SË DRENASIT”**

Neni 2

AUTORIZOHET kryetari i Komunës së Drenasit, z. Ramiz Lladrovci, që të nënshkruaj Plakatin që do të hartohet në bazë të nenit 1 (një) të këtij Vendimi.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës së Drenasit.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohet: Asambleja e Komunës dhe MAPL e Republikës së Kosovës.

Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga data regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Labiriot Halilaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



12 Nr 464-19444 dt. 06.04, 2018

Duke u bazuar në nenin 11,12 dhe nenit 40 pika 40.2 nën 1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 34 pika 34.6 të statutit të Komunës si dhe në bazë të Raportit Nr. 01-463-15202 të datës 15.03.2018 të komisionit mbi vlerësimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale kompanisë “Valdrini”shpk, për Pronën Komunale të marrë në shfrytëzim të përkohshëm nga Komuna e Drenasit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të rregullt të datës 29.03.2018 aprovoi këtë:

V E N D I M
PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS NR.463-34434
TË DATËS 20.06.2016, NË NGASTREN KADASTRALE 726/15 NË ZONËN
KADASTRALE NË DRENAS, QË I ISHIN DHËNË NË SHFRYTEZIM
KOMANISË “VALDRINI” SHPK

Neni 1

Më këtë Vendim, miratohet Kthimi i Pronës Komunale në Zonen Kadastrale në Drenas, gjegjesisht parcela 726/15 në sipërfaqe 1.22.00 Ha, të cilat i ka pasur në shfrytëzim kompania “Valdrini” Shpk.

Neni 2

Shfuqizohet Vendimi Nr.463-34434 i datës 20.06.2016 i Kuvendit të Komunës së Drenasit, me të cilat vendim i është dhënë prona komunale në shfrytëzim kompanisë “Valdrini” sipërfaqja prej S=1.22.00 Ha sipas afatit të shfrytëzimit afatgjatë prej 45 vitesh.

Neni 3

Me këtë vendim do të njoftohet kompania “Valdrini”shpk.

Neni 4

Per zbatimin e këtij vendimi përkujdeset kryetari i Komunes, dhe Drejtoratet përkatëse të komunës së Drenasit.

Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



12 Nr 464-19437 dt. 06.04. 2018

Duke u bazuar në nenin 11,12 dhe nenit 40 pika 40.2 nën I të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 34 pika 34.6 të statutit të Komunës si dhe në bazë të Raportit Nr. 01-463-15202 të datës 15.03.2018 të komisionit mbi vlerësimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale për këmhim me pronën private, gjegjesisht pjesën e parceles 127 në Zonën Kadastrale Korroticë e Ulët, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të rregullt të datës 29.03.2018 aprovoi këtë:

V E N D I M

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS 12 NR.353-12312
TË DATËS 04.03.2015, NË ZONËN KADASTRALE NË KORROTICË TË ULËT**

Neni 1

Më këtë Vendim, miratohet Kthimi i Pronës Komunale në Zonën Kadastrale në Korroticë të Ulët, gjegjesisht pjesa e parceles 720/2, e cila në bazë të vendimit të kuvendit të komunës së Drenasit 12 Nr.353-12312 të datës 04.03.2015 ishte aprovuar për këmhim me pronën private, gjegjesisht pjesën e parceles 127 në Zonën Kadastrale Korroticë e Ulët.

Neni 2

Shfuqizohet Vendimi 12 Nr.353-12312 i datës 04.02.2015 i Kuvendit të Komunës së Drenasit, me të cilat vendim i është aprovuar këmbimi i pronës komunale me pronën private nga ana e kuvendit të komunës së Drenasit.

Neni 3


Me këtë vendim do të njoftohet pronari i pronës private, gjegjesisht i pjesës së parceles 127.

Neni 4

Per zbatimin e këtij vendimi përkujdeset kryetari i Komunes, dhe Drejtoratet përkatëse të komunës së Drenasit.

Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryetari i Kuvendit të Komunës

Flabnor Halilaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



12 Nr 464-19431 dt. 06.04. 2018

Duke u bazuar në nenin 11,12 dhe nenit 40 pika 40.2 nën I të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 34 pika 34.6 të statutit të Komunës si dhe në bazë të Raportit Nr. 01-463-15202 të datës 15.03.2018 të komisionit mbi vlerësimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale kompanisë “Hitchenergy Kosova” me pronar Ali Kastrati nga Polluzha, për Pronën Komunale të marrë në shfrytëzim të përkohshëm nga Komuna e Drenasit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të rregullt të datës 29.03.2018 aprovoi këtë:

V E N D I M

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS 12 NR.351-183
TË DATËS 31.12.2004, NË NGASTREN KADASTRALE 144/2 NË ZONËN
KADASTRALE NË POLLUZHË, QË I ISHIN DHËNË NË SHFRYTEZIM
KOMPANIS “HITCHENERGY KOSOVA” ME PRONAR ALI KASTRATIN NGA
POLLUZHË**

Neni 1

Më këtë Vendim, miratohet Kthimi i Prones Komunale në Zonen Kadastrale në Polluzhë, gjegjesisht parcela 144/2 në sipërfaqe 0.31.00 Ha, të cilat i ka pasur në shfrytëzim kompania “Hitchenergy Kosova” me pronar Ali Kastrati nga Polluzha.

Neni 2

Shfuqizohet Vendimi 12 Nr.351-183 i datës 31.12.2004 i Kuvendit të Komunës së Drenasit, me të cilat vendim i është dhënë prona komunale në shfrytëzim kompanisë “Hitchenergy Kosova” me pronar Ali Kastratit nga Polluzha, në sipërfaqe prej $S=0.31.00$ Ha sipas afatit të shfrytëzimit afatgjatë prej 10 vitesh, sipas kontratës së lidhur me komunën e Drenasit.

Neni 3

Me këtë vendim do të njoftohet kompania “Hitchenergy Kosova” me pronar Ali Kastrati.

Neni 4

Per zbatimin e këtij vendimi përkujdeset kryetari i Komunes, dhe Drejtoratet përkatëse të komunës së Drenasit.

Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Elabimot Halilaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



12 Nr 464-19424 dt. 06.04. 2018

Duke u bazuar në nenin 11,12 dhe nenit 40 pika 40.2 nën I të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 34 pika 34.6 të statutit të Komunës si dhe në bazë të Raportit Nr. 01-463-15202 të datës 15.03.2018 të komisionit mbi vlerësimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale fermerit Rashit Rashiti nga Sankoc, për Pronën Komunale të marrë në shfrytëzim të përkohshëm nga Komuna e Drenasit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të rregullt të datës 29.03.2018 aprovoi këtë:

V E N D I M

**PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS 12 NR.463-16568
TË DATËS 25.03.2015, NË NGASTREN KADASTRALE 295/1 NË ZONËN
KADASTRALE NË SANKOC, QË I ISHIN DHËNË NË SHFRYTEZIM RASHIT
RASHITI NGA SANKOCI**

Neni 1

Më këtë Vendim, miratohet Kthimi i Prones Komunale në Zonen Kadastrale në Sankoc, gjegjësisht parcela 295/1 në sipërfaqe prej 10.00.00 Ha, të cilat i ka pasur në shfrytëzim fermeri Rashit Rashiti.

Neni 2

Shfuqizohet Vendimi 12 Nr.463-16568 i datës 25.03.2018 i Kuvendit të Komunës së Drenasit, me të cilat vendim i është dhënë prona komunale në shfrytëzim fermerit Rashit Rashiti në sipërfaqe prej S=10.00.00 Ha, sipas afatit të shfrytëzimit afatgjatë prej 15 vitesh.

Neni 3

Me këtë vendim do të njoftohet fermeri Rashit Rashiti nga Sankoci.

Neni 4

Per zbatimin e këtij vendimi përkujdeset kryetari i Komunes, dhe Drejtoratet përkatëse të komunës së Drenasit.

Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb fagen zyrtare të Komunës.



Kryetari i Komunitetit të Komunës

Halil Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E DRENASIT
Kuvendi I Komunës.
12 Nr. 400-18828, më 29/04/2018



Në bazë të nenit 40, paragrafi 2. Pika (b) dhe (c) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 34 pika 34.6 nën (c) të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të mbajtur me datën 29.03.2018 aprovoi këtë:

V E N D I M **PËR BARTJEN E TË HYRAVE VETANAKE**

Neni 1

Me këtë Vendim, miratohet bartja e të hyrave vetanake nga viti 2017 në vitin 2018. Mjetet për bartje janë të hyrat vetanake të pashpenzuara gjatë vitit të kaluar.

Neni 2

Të hyrat vetanake të pashpenzuara e që duhet të bartën janë në shumë prej: **507,987.48 €**

Neni 3

Shuma e mjeteve për bartje nga neni 2 i këtij propozim-vendimi do të shpenzohen në këto kategori kryesore ekonomike të shpenzimeve dhe në këto programe – nënprograme të komunës :

I Mallra dhe Shërbime:

- Drejtorati për Arsim (920), nënprogrami (92210), kodi funksional 0911 nga fondi burimore (21) në kategoritë Mallra Shërbime (0130) në shumë prej:..... **10,902.15 €**
- Drejtorati për Arsim (920), nënprogrami (92210), kodi funksional(0911) nga fondi burimore (22) në kategoritë Mallra Shërbime (0130) në shumë prej:..... **1,236.63 €**
- Zyra e Kryetarit (160) nën program (16001), kodi funksional (0111) nga fondi burimor (22) në kategoritë Mallra e Shërbime (0130) në shumë prej:**11.38 €**
- Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale (730) –nënprogramin (73100) kodi funksional 0760 nga fondi burimor (22) në kategorine Mallra e Shërbime (0130) në shumë prej:.. **582.54 €**

Totali (21-22) Mallra Shërbime:12,732.70 €

III. Shpenzime Komunale:

- Drejtorati për Administratë dhe Personel (163) , nën programi (16301), me kod funksional 0133 në kategorinë ekonomike të shpenzimeve – Komunal (0140) në shumë prej:1,41 €

IV. Subvencione dhe Transfere (Nga fondi burimor 21 dhe 22) :

- Drejtorati për Administratë dhe Personel (163) , nën programi (16301), me kod funksional 0133, nga fondi burimor (21), në kategorinë - Subvencione dhe Transfere (200) në shumë prej:.....230.00 €
- Drejtorati për Arsim (920), nënprogrami (92005) kodi funksional 0980 nga fondi burimore (21) në kategoritë Subvencione dhe Transfere (200) në shumë prej:..... 38,871.95 €
- Drejtorati për Arsim (920), nënprogrami (92005) kodi funksional 0980, nga fondi burimore (22) në kategorinë Subvencione dhe Transfere (200) në shumë prej:.....1,371.95 €
- Zyra e Kryetarit (160) nën – program (16001),kodi funksional 0111 nga fondi burimor (22) në kategorinë Subvencione dhe Transfere (200) në shumë prej:1,103.50 €
- Drejtorati për Shërbime Publike dhe Emergjencë (180), nënprogrami (18001), me kod funksional 0451, nga fondi burimor (21), kategorinë Subvencione dhe Transfere (200) në shumë prej:500.00 €
- Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zvillim Ekonomik (470), nënprogrami (47001), me kod funksional 0421, nga fondi burimor (21), kategorinë Subvencione dhe Transfere (200) në shumë prej:408.00 €
- Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale (730) nënprogramin (73010) kodi funksional 0760 nga fondi burimor (21) në kategorinë Subvencione dhe Transfere (200) në shumë prej:..... 1,862.00 €
- Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale (730) –nënprogramin (73010) kodi funksional 0760 nga fondi burimor (22) në kategorinë Subvencione dhe Transfere (200) në shumë prej:..... 60.43 €

Gjithsejtë Subvencione dhe Transfere: 44,407.83€

IV. Shpenzimet Kapitale:

Drejtorati për Administratë dhe Personel (163) , nën programi (16301), me kod funksional 0133, nga fondi burimor (21), bartjen e mjeteve do t'i shpenzoi në këtë projekt kapital:

- Kodi i projektit (44733) në kategorinë Shpenzime Kapitale (300) – Renovimi i ZGJC në Terstenik - Komoran, në shumë prej: 11,849.00 €,

- Drejtorati për Urbanizëm dhe Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit (660), nënprogrami (66310), kod funksional 0620, bartjen e mjeteve do t'i shpenzojë në këto projekte kapitale:

- Kodi i projektit (89031) në kategorinë Shpenzime Kapitale (300) – Ndërtimi i rrugëve lokale) – Asfaltimi i rrugës në Komoran III, në shumë prej: 27,487.23 €,

- Kodi i projektit (40012), në kategorinë Shpenzime Kapitale (300) -Ndërtimi i rrugëve lokale) – Asfaltimi i rrugës në fshatin Arallat lagjia e Kodralive , në shumë prej:30,000.00 €,

- Kodi i projektit (44768), në kategorinë Shpenzime Kapitale (300) - Ndërtimi i rrugëve lokale) – Asfaltimi i Rrugës në Fshatin Shtutice Milaimi Hyseni dhe Bilalli në shumë prej: 40,000.00 €,

- Kodi i projektit (40034) në kategorinë Shpenzime Kapitale (300) - Ndërtimi i rrugëve lokale) – Asfaltimi i Rrugës në Fshatin Gradicë, lagja Ukaj, Leci në shumë prej:23,877.00 €,

- Kodi i projektit (40036), në kategorinë Shpenzime Kapitale (300) - Ndërtimi i rrugëve lokale) – Asfaltimi i Rrugës në Fshatin Terstenik, lagja Bylykbashi në shumë prej: 40,000.00 €,

- Kodi i projektit (44509), në kategorinë Shpenzime Kapitale (300) - Ndërtimi i ujësjellësit) - Ndërtimi i Kapacitetit të Ujësjellësit në (Kamenicë) Drenas në shumë prej:59,602.31 €,

- Kodi i projektit (40041), në kategorinë Shpenzime Kapitale (300) - Ndërtimi i rrugëve lokale – Hartimi i Projekteve Zbatuese për Nevojat të Komunës në shumë prej:3,800.00 €,

- Kodi i projektit (89077), në kategorinë Shpenzime Kapitale (300) – Kanalizim – Kanalizimi i ujrave të zeza në fshatin Gradicë, në shumë prej:10,355.36 €,

- Kodi i projektit (89039), në kategorinë Shpenzime Kapitale (300) Kanalizim – Kanalizimi i ujrave të zeza në fshatin Baicë, në shumë prej:8,370.75 €,

- Kodi i projektit (44748), në kategorinë Shpenzime Kapitale (300) - Ndërtimi i rrugëve lokale – Asfaltimi i rrugës në fshatin Qikatovë e Vjetër, në shumë prej: 28,141.64 €.

Bartjet nga fondi burimor (22) - Shpenzimet Kapitale:

- Kodi i projektit (89096), në kategorinë Shpenzime Kapitale (300) – Ndërtimi i shtëpive – Ndërtimi i Shtëpive për skamnor , në shumë prej:.....13,666.73 €,

- Kodi i projektit (89085), në kategorinë Shpenzime Kapitale (300) - Ndërtimi i rrugëve lokale) – Asfaltimi i rrugës në fshatin Likoshan, në shumë prej:45,052.20 €,

- Kodi i projektit (89036), në kategorinë Shpenzime Kapitale (300) - Ndërtimi i rrugëve lokale – Asfaltimi i rrugës në fshatin Gjergjicë, në shumë prej:25,141.00 €,

- Drejtorati për Shërbime Publike dhe Emergjencë (180), nënprogrami (18001), me kod funksional 0451, nga fondi burmor (21) bartjen e mjeteve do t'i shpenzojë në këto projekte kapitale:

- Kodi i projektit (45961) në kategorinë Shpenzime Kapitale (300) – Furnizimi me rrymë gjenerim dhe transimion) - Renovimi i Ndriqimit Publik me Sistem Intelejgent në shume prej:....715.11 €

- Kodi i projektit (89016) në kategorinë Shpenzime Kapitale (300) – Mirëmbajtje Investive) – Rregullimi i Varrezave në Komunën e Drenasit, në shumë prej:1,092.18 €

- Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale (730) , nënprogrami (73100) Shërbimi e Kujdesit Primar Shendetësor, me kod funksional (0721), nga fondi burimor (21), bartjen e mjeteve do t'i shpenzoi në këto projekte kapitale:

- Kodi i projektit (44726) në kategorinë Shpenzime Kapitale (300) – Paisje Mjekësore (Usg, Monitor AP per 02), në shumë prej:.....560.00 €

- Kodi i projektit (44729) në kategorinë Shpenzime Kapitale (300) – Zgjerimi i QMF –së Gllanasellë, në shumë prej:13,328.40 €

- Drejtorati për Kadastër dhe Gjeodezi (650), nënprogrami (65005) , me kod funksional (0610), nga fondi burimor (21), bartjen e mjeteve do t'i shpenzoi në këto projekte kapitale:

- Kodi i projektit (40009), në kategorinë e Shpenzime Kapitale (300) – Elaborati Kadastral i Komunës, në shumë prej:32,319.36 €

Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport (850) , nënprogrami (85001) Shërbimet Kulturore, me kod funksional (0820), nga fondi burimor (21), bartjen e mjeteve do t'i shpenzoi në këto projekte kapitale:

- Kodi i projektit (43025) në kategorinë Shpenzime Kapitale (300) – Renovimi i sallës së Kulturës, në shumë prej:974.00 €

- Kodi i projektit (89114) në kategorinë Shpenzime Kapitale (300) – Ndërtimi i stadionit Faza e II, në shumë prej:2,136.12 €

Drejtorati për Arsim dhe Shkencë (920) , nënprogrami (92005) Arsim - Administratë, me kod funksional (0980), nga fondi burimor (21), bartjen e mjeteve do t'i shpenzoi në këto projekte kapitale:

- Kodi i projektit (89158) në kategorinë Shpenzime Kapitale (300) – Rregullimi i rrethojës së oborrit SHFMU “Azem Bejta” – Shtuticë, në shumë prej:12,023.90 €
- Kodi i projektit (44878) në kategorinë Shpenzime Kapitale (300) – Rregullimi i rrethojës së oborrit SHFMU “Rilindja ” – Dobroshec, në shumë prej:20,000.00 €

Drejtorati për Arsim dhe Shkencë (920), nënprogrami (92005) Arsim - Administratë, me kod funksional (0980), nga fondi burimor (22), bartjen e mjeteve do t'i shpenzoi në këto projekte kapitale:

- Kodi i projektit (89158) në kategorinë Shpenzime Kapitale (300) – Rregullimi i rrethojës së oborrit SHFMU “Azem Bejta” – Shtuticë, në shumë prej:353.25 €

Totali (21-22) Shpenzimet Kapitale450,845.54 €

Neni 4

Për zbatimin e kwtij vendimi do të kujdeset; Kryetari i Komunës, Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe autorizuesit e programeve – nënprogrameve të buxhetit të komunës .

Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labiriot Halilaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës



12 Nr 02/04-19572 dt. 06.04.2018

Duke u bazuar në nenin 11, 12 paragrafi 12.2 shkronja d Nenit 40 të ligjit për Vetqeverisje Lokale nr.03/L-040 si dhe në bazë të nenit 5, pika 5.2 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërrmarrjet Publike, Nenit 34 pika 34.6 të statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi I Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 aprovoi këtë:

VENDIM

Për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarve për ndërrmarrjen Publike “PASTRIMI”

Neni I

Me këtë Vendim formohet Komisioni Komunal të Aksionarve për ndërrmarrjen Publike “PASTRIMI” I komunës së Drenasit

Neni II

Në kuadër të këtij Komisioni Komunal të Aksionarve për ndërrmarrjen publike, në bazë të nenit 5, pika 5.2, në përbërje duhet të jenë:

- a. Një antarë i emëruar nga Kryetari i komunës dhe
- b. Dy anëtarë të emëruar nga Kuvendi i komunës

NENI III

Dëtyrat dhe përgjegjësit e Komisionit Komunal të aksionarve në baz të nenit 7, pikat (7.1-7.3) janë si me poshtë:

1. Komisioni Komunal i Aksionarve ka të drejtë të veprojnë në emër të komunës në përputhje me ligjin për shoqërit tregtare, se si do të ushtrojnë të drejtat e aksionarit të komunës në një qështje të caktuar

2. Aksionari(ët) e një NP do të ushtrojë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze të veprimtarisë së Bordit të Drejtorëve dhe Komisioneve të Auditimit të NP-së në fjalë,
3. Nëse performanca e NP-së devijon nga caqet e përcaktuara në Planin e Biznesit të miratuar nga Bordi i Drejtorëve për vitin përkatës financiar, Aksionari(ët) do të kërkojnë nga Bordi i Drejtorëve që të përgatisë dhe t'u dorëzojë atyre një raport i cili i shpjegon arsyet për performancën e dobët, dhe Aksionari(ët) do të marrin të gjitha masat e duhura korrigjuese.
4. Nëse një NP dështon në arritjen e caceve të saj të performancës për dy vite financiare radhazi, personi(at) përgjegjës për ushtrimin e të drejtave përkatëse të aksionarit është i detyruar që të marrë parasysh shkarkimin dhe zëvendësimin e Bordit të Drejtorëve ose shumicës së anëtarëve të tij. Një veprim i këtillë mund të ndërmerret edhe në mungesë të provave bindëse të neglizhencës nga Bordi ose anëtarët përkatës të bordit, përveç nëse Aksionari(ët) konstatojnë se performanca e dobët ka ndodhur kryesisht për shkak të rrethanave ose ngjarjeve negative të paparashikueshme. Personat përgjegjës për ushtrimin e të drejtave përkatëse të Aksionarit do t'ia raportojnë çdo vendim të marrë në bazë të këtij Neni 7.3, dhe arsyet për marrjen e këtij vendimi: (i) Kuvendit, për NP-të Qendrore, ose (ii) Kuvendit përkatës Komunal, për NP-të Lokale.

NENI IV

Grupi punues është në këtë përbërje:

1. Lumnije Krapci, e caktuar nga Kryetari i Komunës
2. Bujar Dervishi - antarë nga Kuvendi i Komunës,
3. Petrit Sinani – antarë nga Kuvendi i Komunës,


NENI V

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e kryetarit të komunës.

NENI VI

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga data regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në ~~Udhëzues zyrtar~~ të Komunës.

 Kryetari i Kuvendit të Komunës
Halil Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
Kuvendit i Komunës

12 Nr. 020/04-19440 dt. 06.04.2018

Duke u bazuar në nenin 12 dhe 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3 të Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës në fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e Komunës së Drenasit, nenin 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të rregullt të mbajtur më 29.03.2018 mori këtë:

V E N D I M


I. Për formimin e komisionit për strukturën organizative dhe funksionale të fshatrave dhe lagjeve urbane me qëllim të organizimit dhe zgjedhjeve, funksionimit dhe mbikqyrjes së udhëheqësisë së fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunës së Drenasit në këtë përbërje si vijon:

1. Gani Sylja nga ekzekutivi
2. Kimete Qorri nga ekzekutivi
3. Naim Gjeli antarë nga Kuvendi i Komunës
4. Bedri Nika antarë nga Kuvendi i Komunës
5. Endrit Gllareva antarë nga Kuvendi i Komunës

II. Detyrat e komisionit janë organizimi i zgjedhjeve të organeve të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunës së Drenasit në mbështetje të rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës në fshatra, vendbanime dhe lagjet urbane.


III. Me këtë vendim do të njoftohen anëtarët e komisionit, Drejtoratet e Komunës dhe zyra e Kuvendit si dhe një mbetet në arkiv.

IV. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Edinot Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENASIT
Kuvendi i Komunës
12 Nr.030-19493 dt.06.04. .2018

Duke u bazuar në nenin 11, 12 dhe 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 26 të Ligjit Nr.02/L-57 për Institucionet Kulturore dhe nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me date 29.03.2018 aprovoi këtë:

V E N D I M

- I. Me këtë Vendim riemërtohet Biblioteka e Qytetit të Drenasit me emrin “Ymer Elshani”.
- II. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.
- III. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labiriot Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit(Gllogocit)
Kuvendi i Komunës



12 Nr. 030-19500 dt 06.04 2018

Në bazë të nenit 12 dhe 40 si dhe nenit 52.1 të Ligjit nr.03/L- 040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 13 paragrafi 5 të udhëzimit administrativ Nr.03/2014 për themelimin, përberjen dhe funksionimin e komiteteve të përhershme në Komunë, nenit 38 të Statutit të Komunës së Drenasit, dhe pas dorëheqjes nga pozita e anëtarit të komitetit për politik dhe financa z.Xhavit Drenori, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 29.03.2018 mori këtë:

V E N D I M

Neni 1

Më këtë vendim zëvendësohet anëtari i Komitetit për Politik dhe Financa i Kuvendit të Komunës së Drenasit z.Xhavit Drenori i cili ka dhënë dorëheqje, dhe në vend të tij zgjidhet znj.Fitore Morina e cila vjen po nga i njëjti subjekt politik

Neni 2

Më këtë vendim anëtarja e zgjedhur është e obliguar që ti kryej detyrat dhe ti marre përgjegjësit sipas ligjit për vetëqeverisje lokale

Neni 3

Me këtë Vendim do të njoftohet Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, anëtarët e Komitetit për Politik e Financa, Kryetari i Komunës, Drejtorati i Administratës së Përgjithshme të Komunës, Zyra e Personelit dhe një mbetet për evidencë.

Neni 4

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb-faqen zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labiriot Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit (Glogocit)
Kuvendi i Komunës



12 Nr. 030-19505 dt 06.04. 2018

Në bazë të nenit 12 dhe 40 si dhe nenit 53.1 të Ligjit nr.03/L- 040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 13 paragrafi 5 të udhëzimit administrativ Nr.03/2014 për themelimin ,përberjen dhe funksionimin e komiteteve të perhershme në Komunë, nenit 38 të Statutit të Komunës së Drenasit , dhe pas dorëheqjes nga pozita e anëtarit të komitetit për komunitete z.Vehbi Berisha , Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 29.03.2018 mori këtë:

V E N D I M

Neni 1

Më këtë vendim zëvendësohet anëtari i Komiteti për Komunitete cili ka dhënë dorëheqje z.Vehbi Berisha dhe në vend të tij zgjidhet z.Nexhmedin Bala i cili vjen po nga i njëjti subjekt politik

Neni 2


Më këtë vendim anëtari i zgjedhur është i obliguar që ti kryej detyrat dhe ti marre përgjegjësit sipas ligjit për vetëqeverisje lokale

Neni 3

Me këtë Vendim do të njoftohet Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, anëtarët e Komitet për Komunitete, Kryetari i Komunës, Drejtorati i Administratës së Përgjithshme të Komunës, Zyra e Personelit dhe një mbetet për evidencë.

Neni 4

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labirhot Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
KUVENDI I KOMUNËS
12 Nr. 030-19523 DT. 06.04.2018



Duke u bazuar në nenin 11, 12 pika 12.3 nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenin 8 pika 8.1 shkronja a të Statutit të Komunës, Komisioni për plotësim dhe ndryshim të Statutit të Komunës sa i perket Drejtorive komunale, në bazë të vendimit më nr. 300-7654, të datës 05.02.2018, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më date 29.03.2018 aprovoi:

NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E STATUTIT TË KOMUNËS

Neni 1

Duke u bazuar në nenin 8 të Statutit të Komunës, për ndryshim dhe plotësim të Statutit të Komunës, bëhet plotësim ndryshimi i këtij Statuti me dy Drejtorate të reja, si dhe riformulime në emërtim dhe modifikim të detyrave dhe përgjegjësi të dy Drejtorateve ekzistuese.

Neni 2

Të neni 76 i Statutit të Komunës, të Drejtoratet Komunale, nenparagrafit 76.1, shtohet pika k Drejtorati i Infrastruktura Lokale dhe pika l Drejtorati për Zhvillim Ekonomik.

Neni 3

DREJTORATI PËR INFRASTRUKTURË LOKALE

Ky Drejtorat:

1. Harton programin zhvillimor afatmesëm dhe afatgjatë të infrastrukturës në nivel të Komunës, në harmoni me zhvillimin urbanistic, me kërkesat dhe nevojat e qytetarëve në vendbanime urbane dhe vise rurale.
2. Përgatitë detyra projektuese, harton projekte të infrastrukturës dhe ndërtimit sipas kërkesave të administratorëve dhe bënë kategorizimin e objekteve të infrastrukturës urbane dhe rurale.
3. Përcjellë dhe studion rrjedhat e zhvillimit të infrastrukturës së Komunës dhe cakton kriteret e ndërtimit të infrastrukturës rrugore.

4. Lëshon leje të infrastrukturës rrugore, leje për gropim dhe hapje të kanaleve, të cilat i bëjnë ndërrmarrjet publike si dhe leje për kyqje individuale të qytetarëve në rrjetin e infrastrukturës.
5. Cakton organin mbikqyrës për mbikëqyerjen dhe komisionin për kontrollim teknik të objekteve të ndërtuara, në bashkëpunim me departamentin e prokurimit.
6. Është përgjegjës për menaxhimin (mbikëqyrjen) e ndërtimit, rindërtimit të infrastrukturës rrugore (kanalizimet fekale, atmosferike, kablllore, ujësjellës, asfaltimin, ndriçimin publik, sinjalizimin horizontal dhe vertikal) në qytet dhe vise rurale.
7. Kontrollon dhe mbikëqyrë cilësinë e materialit ndërtimorë, nëpërmjet laboratorit të licencuar për përputhshmëri me norma teknike të pranuara në nivel ndërkombëtar.
8. Bashkëpunon me zyren e prokurimit, me qëllim të jetësimit të kontratave të nënshkruara për krytjen e punimeve të infrastrukturës dhe ndërtimit.
9. Kryen edhe punë të tjera, në bazë të ligjeve të aplikueshme në kuadër të fushëveprimtarisë së Drejtorisë.

Neni 4

DREJTORATI PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Ky Drejtorat:

1. Në bashkëveprim me Kryetarin e Komunës dhe Institucionet tjera Komunale, do të krijojmë një kornizë të përshtatshme për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror,
2. Hartimin e strategjisë zhvillimore lokale në përputhje me strategjinë regjionale dhe atë qendrore, duke përfshirë të gjithë sektorët e ekonomisë, si në aspektin afatshkurtër edhe në atë afatgjatë.
3. Hartimin e politikave zhvillimore dhe marrjen e masave të përshtatshme për të nxitur më tutje zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të Komunës.
4. Hartimin e planeve dhe nxitjen e investimeve të jashtme me qëllim të realizimit të projekteve komunale.
5. Hulumtimin e mundësive për të siguruar donacione dhe burime të tjera financiare.
6. Ofrimin e trajnimeve dhe dhënien e këshillave për bizneset lidhur me mundësitë për të investuar kapitalin e tyre në veprimtaritë prodhuese dhe ku janë mundësitë më të mira për të kthyer investimin e bërë dhe avancimi i bizneseve të tyre.
7. Ofrimin e shërbimeve për regjistrimin e bizneseve - Qendra e Regjistrimit të Bizneseve.
8. Bashkëpunimi dhe koordinimi i projekteve lidhur me Partneritetet Publiko Privat.
9. Bashkëpunimin me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, MIN, MTI, MZHR dhe resorëve tjerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës rreth mundësive dhe koordinimit të aktiviteteve lidhur me realizimin e strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal.
10. Në bashkëpunimin me Kryetarin e Komunës bashkëpunon me Institucionet Ndërkombëtare dhe organizatave të ndryshme financiare për projekte të ndryshme zhvillimore.

11. Organizimin e panairove për promovimin e produkteve dhe shërbimeve të bizneseve.
12. Komunikimin e vazhdueshëm me diasporën që të jenë të informuar lidhur me lehtësirat, planet zhvillimore, projektet dhe mundësitë praktike që ofron Komuna në raport me investitorët e mundshëm.
13. Promovimin e turizmit në aspektin ekonomik lokal dhe
14. Fuqizimin e bashkëpunimit dhe komunikimit me Diasporën (Mërgatën) dhe promovimin e bizneseve nga Diaspora dhe mundësitë e investimeve në Komunë për bizneset e Diasporës.

Neni 5

Neni 85 i Statutit të Komunës: Drejtorati për Bujqësi dhe Zhvillim ekonomik riformulohet më emërtimin: “Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural”, dhe modifikohen detyrat dhe përgjegjësitë e këtij Drejtorati.

Neni 6

DREJTORATI PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Ky Drejtorat:

1. Implementon politikat zhvillimore në sektoret e Bujqësisë.
2. Koordinon dhe mbikëqyrë asociacionet Bujqësore.
3. Përgatit planet për mbjelljet pranverore, vjeshtore dhe fushaten për korrje-shirje.
4. Organizon trajnime dhe këshillime për fermerët.
5. Jep pëlqim për rikultivimin e tokave Bujqësore.
6. Mban evidencen për tokat Bujqësore .
7. Bashkëpunim dhe përkrahjen e aktiviteteve rreth ujitjes në Kompaninë e “Iber Lepencit” .
8. Bënë mbrojtjen e resurseve natyrore duke përfshirë pyjet, reren (zhavorin) dhe aktivitetet tjera rreth gurëthyesve.
9. Koordinon punët dhe bashkëvepron me OJQ-të që përkrahin aktivitetet Bujqësore.
10. Bashkëpunon me agjencionet qeveritare për zhvillimin e rajoneve rurale.
11. Planifikon zhvillimin dhe kujdesin permanent të shfrytëzimit të tokës Bujqësore për nevojat dhe intereset e Komunës.
12. Bashkëpunimi dhe koordinimi me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
13. Mbrojtja e Pyjeve, Pyllëzimi dhe Ripyllëzimi.
14. Planifikimi i Zhvillimit Rural.
15. Hulumton resurset natyrore duke përfshirë edhe mbrojtjen e shtazëve dhe bimëve.

Neni 7

Neni 81 i Statutit të Komunës: Drejtorati për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, modifikohen detyrat dhe përgjegjësitë e këtij Drejtorati.

Neni 8

DREJTORATI PËR URBANIZËM DHE MBROJTJE TE MJEDISIT

Ky Drejtorat:

1. Menaxhon me Planet Hapësinore të Komunës (Planin Zhvillimor Komunal, PZHK, Hartën Zonale të Komunës, HZK dhe Planet Rregulluese të Hollësishme),
2. Lëshon leje ndërtimore, sipas ligjeve dhe udhëzimeve administrative në fuqi,
3. Udhëheqë procesin e Legalizimit të objekteve (sipas ligjeve dhe udhëzimeve administrative në fuqi),
4. Harton kriteret për dhënien me qera të objekteve komunale dhe tokës ndërtimore të Komunës,
5. Harton programe, detyra projektuese me ndihmën e eksperteve të përzgjedhur për organizimin e konkurseve urbanistiko-arkitektonike,
6. Koordinon dhe menaxhon mbledhjen e informatave për GIS nga organizatat dhe drejtoratet tjera të Komunës,
7. Mban evidencën për emërtimet e vendbanimeve, rrugëve, shesheve si dhe numrat e objekteve dhe shtëpive brenda teritorit të Komunës (Sistemi Aris),
8. Kujdeset për ruajtjen e mjedisit,
9. Harton rregullore dhe plane të ndryshme për çështje mjedisore, zbatimi i legjislacionit dhe raportimi, marrja e të dhënave nga drejtoratet tjera që kanë të bëjnë me çështje mjedisore,
10. Merret me menaxhimin e objekteve banesore,
11. Kryen edhe punë të tjera, në përputhje me ligjet e aplikueshme në kuadër të fushë veprimtarisë së Drejtoratit.

A r s y e t i m

Komisioni për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të komunës, bazuar në autorizimet që i janë dhënë me vendimin e Kryetarit të komunës, ka bërë punën e tij duke marrë në konsideratë legjislacionin në fuqi për të inkorporuar në statutin ekzistues, si dhe duke i inkorporuar në tekstin e ndryshuar dhe të plotësuar të statutit dy drejtorate shtesë, ka paraparë modifikime ne emërtim dhe përgjegjësi të dy Drejtorateve ekzistuese.

Duke marrë në konsideratë vërejtjet eventuale apo sugjerimet për ndryshime dhe plotësime të këtij propozim-plotësim ndryshimi të Statutit të Komunës, propozojmë që këto ndryshime të dërgohen në shqyrtim fillestar në Kuvendin e Komunës pastaj të ipen në diskutim publik konform rregullatës ligjore në fuqi.

Drejtorati për Infrastrukturë Lokale

Në bazë të Statutit të Komunës së Drenasit Kapitulli II, neni 76 janë të përcaktuara Drejtoratet Komunale, në pikën (e) është e përcaktuar Drejtorati për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, ndërsa në nenin 81 janë të përshkruara përgjegjësitë e Drejtoratit. Duke pasur parasysh vëllimin e punimeve që është në bazë të përshkrimit të detyrave të punës dhe numri i vogël i punëtorëve është vlerësuar e arsyeshme që të bëhet ndarja e sektorëve të drejtoratit ekzistues në dy drejtori të reja dhe atë në:

Drejtorati për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe
Drejtorati për Infrastrukturë Lokale Kjo ndarje bëhet me qëllim të ushtrimit të funksioneve të përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi.

Në kuadër të Drejtoratit për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit do të ishte sektori i Planifikimit dhe sektori i Mjedisit. Ky drejtorat do të kishte përgjegjësi për çështjet e planifikimit hapësinor, hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve hapësinore dhe urbanistike si dhe do të merret me çështjet e hartimit të planeve që lidhen me mjedis, zbatimin dhe monitorimin e tyre si dhe me legjislacionin në fuqi që ka të bëjë me këtë fushë si dhe çështjet banesore .

Drejtorati për Infrastrukturë Lokale do të ndahej në dy sektore, sektori i Infrastrukturës dhe sektori i Ndërtimit të projekteve kapitale sipas buxhetit të planifikuar.

Sektori i infrastrukturës do të merret me punët që lidhen me infrastrukturën (rrugë, kanalizim, ujësjellës, ndriçim publik etj.), ndërsa sektori i ndërtimit do të merret me ndërtimin e objekteve të ndryshme arsimore, shëndetësore, administrative, sportive etj.

Numri i projekteve kapitale që janë menaxhuar nga zyrtarët e DPUMM ka qenë 82 sipas listës së projekteve kapitale të miratuara në Kuvendin e Komunës për vitin 2017, gjithashtu disa prej tyre kanë pasur edhe aneks kontrata.

Në bashkëfinancim me Ministrinë e Infrastrukturës kanë qenë rreth 15 projekte kapitale.

Kemi pasur edhe objekte shëndetësore, objekte arsimore, objekte sportive dhe kulturore të cilat janë financuar nga buxheti i Komunës dhe donatorë tjerë.

Shumica prej këtyre projekteve të lartëpërmendura janë menaxhuar dhe mbikëqyrur nga zyrtarët e DPUMM dhe një pjesë nga zyrtarët e drejtorateve tjera brenda Komunës.

Ndarja e drejtoratit në dy drejtorate të reja do të ndikoj pozitivisht për arsye që zyrtarët përkatës do të kenë mundësinë që të punojnë ekskluzivisht me punët dhe detyrat që i përkasin sepse deri më tani sektori i planifikimit është marrë me punë të infrastrukturës dhe janë lënë anash punët në planifikim. Poashtu është e nevojshme që të rritet stafi i zyrtarëve brenda dy drejtorateve të reja në mënyrë që të kryhen punët sipas planifikimit.

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik ka si mision mbështetjen e procesit të hartimit dhe zbatimit të politikave të qeverisë lokale, për një zhvillim të integruar të sektorëve prioritarë të ekonomisë, përmes dhënies prioritet dhe rritjes së efektivitetit të investimeve publike, nxitjes së bashkëpunimit lokal dhe rajonal që ndikojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve si dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara në fushën e zhvillimit ekonomik lokal.

Gjithsej biznese të regjistruara në bazë të dhënave nga ARBK

Të regjistruara **3818**

Të shuara **543**

Biznese të regjistruara nga 1-5 punëtor janë **3693**

Biznese të regjistruara nga 5-60 punëtor janë **123**

Biznese të regjistruara nga 60 e më shumë punëtor janë **2**

Biznese të shuara nga 1-5 punëtor janë **532**

Biznese të shuara nga 5-60 punëtor janë **11**

Tabela e klasifikimit të bizneseve të regjistruara sipas numrit të punëtorëve

Klasifikimi sipas madhësisë	Numri i punëtorëve	Numri i bizneseve	Përqindja në total
Të vogla	1-5	3693	96.72
Të mesme	5 - 60	123	3.23
Të mëdha	60 - e më tepër	2	0.052
Gjithsej:		3818	100.00%

Tabela e klasifikimit të bizneseve të shuara sipas numrit të punëtorëve

Klasifikimi sipas madhësisë	Numri i punëtorëve	Numri i bizneseve	Përqindja në total
Të vogla	1-5	532	97.97
Të mesme	5 - 60	11	2.03
Të mëdha	60 - e më tepër	0	0
Gjithsej:		543	100.00%

Duke pasur parasysh vëllimin e punimeve që është në bazë të përshkrimit të detyrave të punës dhe numri i vogël i punëtorëve është vlerësuar e arsyeshme që të bëhet ndarja e sektorëve të drejtoratit ekzistues si Drejtori e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Ekonomik në dy drejtori të ndara. Në Drejtoratin e Zhvillimit Ekonomik funksionimi si një drejtori e ndarë do të ndikonte dhe do të jepte një rezultat mjaftë të dobishëm në realizimin e objektivave bazuar në kompetencat që i ka ky drejtorat në bazë të Ligjit për Vetqeverisje Lokale.


Në funksionimin e Parkut të Biznesit po ashtu në zgjerimin e parkut të biznesit që pritet të bëhet sipas investimit milionësh nga BERZH si dhe funksionimi i kompanisë Feronikeli dhe kompani të gurëthyesit, funksionimi i të cilave është shumë e nevojshme dhe që hyjnë në kuadër të zhvillimit ekonomik. Paraqesim propozimin për ndarjen e këtij drejtorati nga Drejtorati për Bujqësi për arsye se Drejtorati i zhvillimit ekonomik duke funksionuar në mënyrë të ndarë dhe duke i realizuar veçmas të gjitha objektivat e veta do i mundësonte Komunës së Drenasit një zhvillim ekonomik më të madh në të cilën rezultatet janë mjaftë pozitive duke krijuar hapësirë për vende të reja të punës dhe duke ndikuar në zbutje të papunësisë si rezultat i rritjes së zhvillimit ekonomik në vend.

Po ashtu do të ketë ndikonte në rritjen e prodhimit, në shërbime më cilësore, rritje të punësimit, rritje të mirëqenies sociale dhe rritje të investimeve kapitale.

Në aspektin financiar, me rishikim të buxhetit ka mundësi që të parashihen pagat për dy Drejtor të Drejtorateve të reja, dy apo tre zyrtar të Drejtorateve ekzistuese, si: Drejtoratit për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit të transferohen në Drejtoratin për Infrastrukturë Lokale, dhe dy apo tre zyrtar të Drejtoratit për Bujqësi dhe Zhvillim Ekonomik të transferohen në Drejtoratin për Zhvillim Ekonomik, ndërsa zyrtar tjerë të parashihen me buxhetin e vitit 2019.

Neni 9

Ky plotësim ndryshim I statutit të Komunës hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Këshillit të Komunës

Labiriot Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit(Gllogocit)
Kuvendi i Komunës

12 Nr. 030-19516 dt 06.04. 2018

***Për ndryshim-plotësimin e RREGULLORËS
PËR TAKSA, TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA***

2018

Glllogoc

Duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 shkronja c nenit 40 pika 40.2 shkronja a të ligjit për vetqeverisjen lokale nr.03/L-040 („Gaz.Zyrt.e Republikës së Kosovës”), nenit 2 paragrafi 3 ,nenit 8,10,12,14,15 dhe 18 të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr. 03/L-049 („Gaz.Zyrt.e Republikës Kosovës”),UA I MMPH nr. 14/2015 dhe UA I MMPH nr. 01/2017, nenit 59 të statutit të Komunës së Glllogocit të aprovuar në vitin 2008 dhe shkresës nga MAPL nr.43-468/1 e dt.17.11.2017, si dhe shkresës percjellse t MAPL-s nr.43-339/3 t dats 28.03.2018 dhe rekomandimeve t dhena nga Ministria e Financave 43-339/2 t dats 26.03.2018 Kuvendi i Komunës së Glllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 aporvoi këtë:

Ndryshim Plotësimin e : RREGULLORËS

PËR TAKSA TARIFA NGARKESA DHE GJOBA

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Me këtë Rregullore përcaktohen kriteret për obliguesit ndaj shërbimeve komunale si: lartësia e pagesës, mënyra e ngarkesës - llogaritjes,mënyra e arkëtimit, afati i pagesës, mbikqyrja inspektuese, evidentimi,taksat dhe gjobat,pastaj dispozitat ndëshkuese, si dhe ankesat në ngarkesat e parapara në vazhdim të kësaj Rregulloreje.

Neni 1

Bartës të obligimeve për shërbimet komunale janë personat fizikë dhe juridikë

- 1.1. Personat, të cilët paraqesin kërkesë për çertifikata të ndryshme, vërtetime apo deklarata të cilat lëshohen nga Drejtoritë komunale.
- 1.2. Personat juridikë dhe fizikë, të cilët bëjnë procesimin e kërkesave të tyre për pelqimin për Biznes.
- 1.3. Personat/Subjekte afariste dhe profesionalistët që kërkojnë marrjen e pëlqimit nga Drejtorati përkatës për Pelqimin për punë në biznes dhe leje të tjera specifike.
- 1.4. Personat/Subjekte afariste që kërkojnë marrjen e lejës për mjetet motorike.
- 1.5. Personat të cilët bartin pronat përmes transaksioneve.
- 1.6. Personat të cilët janë shfrytëzues të përkohshëm të tokës dhe pronës me ndërtime dhe pa ndërtime.
- 1.7. Subjektet apo personat të cilët organizojnë manifestime sportive dhe kulturore
- 1.8. Subjekti fizik apo juridik për ndërtimin e ndërtesave individuale banesore, banesave kolektive dhe hapsirave afariste.
- 1.9. Subjektet apo personat tek të cilët kryhet inspektimi i përshkruar në tarifën përkatëse.
- 1.10. Subjektet, të cilët mirren me shfrytëzimin e resurseve natyrore të parapara me tarifën përkatëse .

- 1.11 Subjektet apo personat, të cilët paraqiten pronarë, mbajtës të shtazëve dhe kafshëve të tjera përkëdhelëse.
- 1.12. Subjektet apo personat, të cilët kërkojnë nga Drejtorati për Kadaster Gjeodezi dhe e Pronë shërbime sipas tarifës së përcaktuar.
- 1.13. Subjektet apo personat për shfrytëzimin e sipërfaqeve publike për biznese dhe parkingje sipas tarifave përkatëse.
- 1.14 Subjektet apo personat juridik e fizik të cilët kanë pronë apo janë shfrytëzues të pronës e që janë të obliguar ta paguajnë Tatimin mbi pronën.
- 1.15 Subjektet apo personat juridik dhe fizik duhet ti nënshtrohen ligjit të komunikacionit dhe të cilët u përgjigjen edhe ndëshkimeve (gjobave) në trafik.
- 1.16. Subjektet apo personat, të cilët bëjnë ekspozimin publik të vitrinave reklamuese, apo panove reklamuese, si dhe organizimin e lojërave argëtuese të fatit dhe lojërave automatike, si dhe rekuizitave të tjera sportive sipas tarifave përkatëse.
- 1.17. Personat që paraqesin kërkesë për caktimin e kushteve urbanistike – teknike,
- 1.18. Personat që paraqesin kërkesë për leje ndërtimore,
- 1.19. Personat që paraqesin kërkesë për leje përdorimi.
- 1.20 .Subjektet apo personat juridik dhe fizik për regjistrim apo reregjistrim të automjeteve
- 1.21. Personat që paraqesin kërkesë për leje pune në afarizëm .

Neni 2

Lartësia e shumës për kërkesë për dhënien e Lejës së punës, deklaratës, vërtetimit, për ushtrimin e veprimtarive në biznese, rentave, qerasë-shfrytëzimit të hapsirave komunale, lejeve ndërtimore, kompenzimeve për inspektime, gjobave dhe pagesa të tjera, përcaktohen me tarifa përkatëse, të cilat janë pjesë përbërëse të kësaj Rregulloreje.

Neni 3

Tarifat e subjekteve caktohen sipas kësaj Rregulloreje, me aktvendime të Drejtorateve sipas kërkesave të paraqitura.

Për ngarkesa të tjera obligimet llogariten dhe paguhen me rastin e dorëzimit të kërkesës nga ana e subjekteve të ndryshme.

Neni 4

Subjektet, tarifën e caktuar në bazë të aktvendimit përkatës, do ta paguajnë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të aktvendimit.

Përgjatshimisht nga alinea 1. e këtij neni, ngarkesat e caktuara për operimin e firmave dhe të tatimit në pronën e qytetarëve dhe të personave juridikë, do të paguhen në 2 kiste të barabarta dhe atë:

- Për subjekte afariste Kisti i parë deri më 30 qershor,
- dhe kisti i dytë deri më 31 dhjetor të vitit .

Neni 5

Nëse obligimet e caktuara me vendim nuk paguhen brenda afatit të caktuar sipas neni

paraparak, ndëshkimet do të aplikohen në bazë të kësaj Rregulloreje.

Neni 6

Në rast të mospagesës së taksës, Komuna do të veprojë sipas dispozitave ligjore, duke shfrytëzuar të drejtën e mbylljesë së subjekteve afariste dhe paraqitjen në gjykatën kompetente.

Neni 7

Drejtoritë përkatëse komunale për ngarkesat dhe pagesat sipas kësaj Rregulloreje, do të mbajnë evidenca në harmoni me dispozitat përkatëse ligjore.

Neni 8

Për zbatimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje, në kuader të autorizimeve të veta kujdesen Drejtoritë përkatëse. Por nëse gjatë punës së tyre, Drejtoratet hasin në parregullësi, do të bëjnë përpjekje për t'i evituar ato dhe do të bëjnë propozime përkatëse për eliminimin e parregullësive.

Këto punë, Drejtoratet do t'i kryejnë përmes personave zyrtarë.

Neni 9

Obliguesit duhet t'i paguajnë ngarkesat dhe taksat sipas Rregullores komunale në llogaritë përkatëse të Komunës drejtpërsëdrejti në arkë deri në 10 € ndërsa përmes bankave afariste në shumën mbi 10 €.

ANKESAT DHE MBROJTJA JURIDIKE

Neni 10

Personi mund të bëjë ankesë ndaj vendimit të lëshuar nga Komuna, nëse ai /ajo mendon se i janë shkelur të drejtat e tij. Procedura e ankesës duhet të jetë në pajtueshmëri me procedurën e referuar në nenin 85 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040.

Neni 11

Ndaj vendimit përfundimtar të Komunës mund të ushtrohet ankesë Komisionit për shqyrtimin e ankesave nga taksat ngarkesat e gjobat të Ministrisë së Ekonomisë e Financave dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

1. – TAKSAT DHE NGARKESAT PËR LËSHIMIN E DOKUMENTEVE ZYRTARE

Neni 12

Implementues: Drejtoria e Administratës dhe organet tjera komunale, të cilat në procedurë administrative vendosin lidhur me parashtrësat e subjekteve - parashtruesve të kërkesave për lëshimin e dokumenteve zyrtare, kopjeve të dokumenteve nga evidenca zyrtare, si dhe për shërbimet e përcaktuara në këtë tarifë.

Obligues: Parashtruesit e kërkesave.

Arkëtimi i pagesës : Me rastin e dorëzimit të kërkesës.

2.Tarifat për lëshimin e Certifikatave dhe dokumentacionit zyrtar

Dhënia e certifikatave nga shërbimi I ofiqarisë

1	Certifikata – Extrakt i lindjës	1 €
2	Certifikat Martese	1 €
3	Certifikat Vdekjës	1 €
4	Vertetim nga arkivi	1 €
5	Certifikat për gjendjen i/e lirë për martes	2 €
6	Certifikata e shtetësisë	1 €
7	Certifikat për ç'lajmerimin e vendbanimit	1 €
8	Certifikat mbi vendbanimin	1 €
9	Deklarata e bashkësisë familjare	1 €
10	Deshmi vdekjeje (regjistrimi i trashëgimisë)	2 €
11	Ceremoni martesore në mes të personav vendor	5 €
12	Martesat kur njeri nga bashkshortët është Shtetas I huaj	10 €
13	Ceremoni martesore jasht organit dhe jasht orarit zyrtar	20 €
14	Per ceremoni jasht organit dhe jashtë orarit zyrtar. (pagesa dokumentohet me dokument zyrtar i vertetuar nga organi përkatës)	25 €
15	Vertetime dhe dokumente të ndryshme	1 €
16	Aktvendimi për regjistrimin e mëvonshëm në RGJC dhe ndryshimi	5 €
17	Kërkesa për humbje dhe fitim të shtetësisë	10 €

2.1 Tarifat tjera të Sektorit të Ofiqarisë

1	Dhënja e çdo lloj certifikate në bazë të dy (2) dëshmitarëve	2 €
2	Certifikata për bashkësin familjare (shtesa feminare)	3 €
3	Legalizimi I fotokopjeve duke krahasuar me origjinalin (1 faqe me tekst)	1 €
4	Vertetim tjetër për qeshtje pensioni	3 €
5	Deklarata për ushqimin në vitin kalendarik	5 €

6	Për qdo kopje të diplomës	1 €
7	Për qdo kopje të certifikatave të legalizueme	1 €
8	Për legalizimin e Aktgjytimeve deri në 2 faqe	1 €
9	Për legalizimin e dokumenteve të Udhtimit	1.50 €
10	Për Legalizimin e skicave të pronës së palujtëshme	5 €

Nga sherbimi i arhivës:

1	Dhënja në shfrytëzim e projektit nga dokumentet, të cilat gjenden në kuader të dokumentacionit teknik për një ditë – persona privat	10 €
2	Për organet shtetërore – private	10 €
3	Fotokopje formati A3	0.60 €
4	Fotokopje formati A4	0.30 €
5	Fotokopje për hulumtues kopje A3	0.60 €
6	Fotokopje për hulumtues kopje A4	0.30 €
7	Certifikata nga librat amë. Evidencat për banor, përgatitja shkollore e të ngjashme	3 €
8	Kerkesa të ndryshme	1 €
9.	Ankesa bëhet pa pagesë	

Nga pagesa e kësaj takse janë të liruar familjet e ngushta të dëshmorëve, invalidët e luftës të të gjitha kategorive, veteranet dhe rastet sociale, provë për këtë janë vërtetimet përkatëse.

Neni 13

Ngarkesat vjetore për ushtrimin e veprimtarisë afariste biznesore në teritorin e Komunës Glogoc??

Veprimtaria	Tarifa
Metalurgjia e rëndë-shkritoret	70.000
Minierat	30.000
Gurëthyesit	4.000
Postat, shërbimet postare	1000
Bankat	2.500
Bankat Mikrofinanfiare	1.000
Trafot kryesore-shpërndarës të energjisë elektrike	3.000
Kompanitë e sigurimeve që mirren me sigurimin e automjeteve, pasurisë personave etj	500
Bastoret	3.000

Pompat e derivative në rrugë magjistrale		3.000
Pompat e derivative në rrugën regjionale		1.500
Pompat për derivate në rrugë lokale		300
SHPK të tjera		250
NTP,NN,NSH,NH si dhe ato përpunuese si dhe të gjitha tipet e ndermarrjeve		
Ndermarrjet shërbyese prej ma të ndryshmeve		

.Kulturat e drithërave,perimeve hortikultura dhe mullinjët		
.Blegtoaria		
.Kulturat bujqësore,rritja e bagëtive,shpendëve dhe kafshëve tjera.		

.Veprimtaritë shërbyese veterinere.		300
.Prodhimi i veshjeve me lëkurë		
.Prodhimi i këpucëve dhe mbathjeve tjera		
Prodhimi i zdrukutarisë dhe elementeve tjera(Dyer,dritare tj)		
.Prodhimi i produkteve tjera prej letre,kartuçi.		
Prodhimi i lëndëve plastike		800
.Prodhimi i produkteve tjera kimike		1000

13.2. Veprimtarit tjera		
Ordinancat Shëndetsore		600
Barrnatores		500
Kontrollime teknike		500
Shpërndarës të internetit dhe TV kabllorë		300
Permbaruesit Privat		1.000
Avokaturat		500
Noteri		700
Vlersues të Pronave		500
Lojrat e fatit, automatët dhe klubet e veqanta(klubet e natës)		3.000
Klubet e veqanta (diskotekat)		2.000
Eksplotimi –grumbullimi i rëres për qellime komerciale		1.000

Veprimtaria e Qerdheve		50
Agjensit e ndermjetsimit në transaksionet e pasurisë së patundshme dhe agjensionet tjera.		500
Veprimtarit e Shtypshkronjave dhe aktiviteteve grafike		200
Tregtija e Automjeteve të reja		500
Tregtia e Automjeteve të vjetra dhe autopjesë të vjetra		300
13.3. Njësit e ndërmarrjeve që e ushtrojnë veprimtarinë në teritorin e Komunës paguajnë 30% të tarifës bazë (në rastet që edhe selia është në teritorin e Komunës së Drenasit)		
13.4. Bizneset të cilat licencohen nga Ministritë përkatëse,paguajnë taksën Komunale e cila shërben si provë për licencim janë të specifikuar në nenin 13.2 të kësaj rregullore.		
13.5.Tregëtia me shumicë e artikujve ushqimor lirohet 30% në zonat rurale të Komunës së Drenasit.		

- Të gjitha Bizneset fillestare të regjistruara nga viti 2013 vazhdojnë të lirohen nga pagesa e Taksës Komunale për 1 vitë kalendarik, Deri në fund të vitit 2018.

1. Bizneset fillestare të cilat punësojnë mbi 10 punëtorë lirohen nga taksa Komunale për 5 vite duke filluar nga viti 2018.
2. Duke filluar nga viti fiskal 2018 vazhdojnë të lirohen për kohë të pacaktuar nga pagesa e Taksës Komunale të gjitha Bizneset ekzistuese dhe ato fillestare që ushtrojnë veprimtaritë e tyre në të gjitha sektorët e prodhimtarisë Bujqesore.
3. Të gjitha bizneset që ushtrojnë veprimtari me pakicë (DPZ, DPT,DPSH,DPH ,Taksi shërbimet etj.) nga viti 2014 lirohen nga taksa Komunale për kohë të pacaktuar .

4. Të gjitha bizneset që raportojnë në ATK , me pasqyrëza financiare (formular) të pagesës së tatimit në qarkullim e të cilët dorzohën për atë vitë kalendarik me zero qarkullim lirohën edhe nga taksa Komunale për atë vitë kalendarik që nuk kanë ushtruar veprimtarinë duke i sjellur si dëshmi pasqyrzat financiare të vertetuara nga ATK-ja.

Neni 14

Implementues Drejtorati për Shërbime Publike

Nr.i tarifës, dhe i qark	Shërbimet	Vlerë vjetore e Euro
	Gjobat	
	Kyçja pa leje në rrjetin e ujësjellësit	
14.1	Personi fizik	300
14.2	Personi juridik	500
	Kyçja pa leje në rrjetin e kanalizimit publik	
14.3	Personi fizik	300
14.4	Personi juridik	500
	Derdhja e ujërave të zeza në hapësirën publike	
14.5	Personi fizik	300
14.6	Personi juridik	500
14.7	Gjobat për Hedhjen e mbeturinave (UA 14/2015 I MMPH neni 16)	
14.8	Hudhja e cigarës në rrugë, çamçakezit etj.	5
14.9	Hudhja e ambalazhë dhe mbeturina (qelq, Leter, konaqe, mbeturina ushqimore etj) në sipërfaqe publike	10

14.10	Hedhja e mbeturinave jasht kontejner,shkaperderdh(mbet.organike,qelqi etre etj)	20
14.11	Hudhja e mbeturinav (cigars,letrës,plastike konaqe etj) nga automjeti	30
14.12	Hudhja e mbeturinav (cigars,letrës,plastike konaqe etj) nga ballkoni, në kuseta kanalizimi,ngjyra etj	50
14.13	Hudhja e mbeturinav jashtë kontejneri apo vendev të percaktuar të gjitha llojeve të mbeturinav	70
14.14	Hudhja e qfardo mbeturine në proskat e lumejve,liqeneve kanalizimev apo tjera	100
	Për keqpërdorimin e ujit të pishëm	
14.15	Personi fizik	50
14.16	Personi juridik	100
	Gërvishtja, prerja, lakimi, ndotja ose dëmtimi në ç'fardo forme i objekteve me interes të përgjithshëm siç janë : ndriçimi publik, shenjat e komunikacionit etj.	
14.17	Dëmtimi i shtyllës ndriçuese (komplet)	350
14.18	Dëmtimi i bimëve dekorative nëpër parqe.	20
14.19	Dëmtimi i ulëseve dhe pjesëve përcjellëse të parqeve (ndotja, thyerja dhe dëmtime tjera)	30
14.20	Dëmtimi i rrethojave për mbrojtjen e gjelbërimit për m ²	30
	Kalimi (shkelja) me këmbë nëpër sipërfaqet e gjelbëruara të parqeve dhe hapësirave të tjera të ndaluara publike	
14.21	Personi fizik	10
14.22	Kalimi (shkelja) me automjet nëpër sipërfaqet e gjelbëruara të parqeve dhe hapësirave të tjera të ndaluara publike	50
	Larja e veturave dhe automjeteve të tjera në trotuar dhe rrugë.	Shuma në €

14.23	Personi fizik	10
14.24	Personi juridik	30
	Shërbimet	
	Tërheqja dhe vendqëndrimi i automjeteve të konfiskuara	
14.25	Bartja e automjetit më automjet të posaqem për bartje (20% për Komunën)	30
14.26	Bartja jashtë zonës së qytetit për 1/km	1

	Taksat për leje operimi	
	Leje për bllokim të rrugës (shiriti rrugor – trotuarit)	Shuma €
14.27	Zona urbane 12 - orë	20
14.28	Zona urbane 24 - orë	25
14.29	Leje për ndalje (ngarkim shkarkim) të mallrave në rrugë dhe trotuar, në afërsi të lokaleve afariste, për një ditë	3
14.30	Leje për ndalje (ngarkim shkarkim) të mallrave në rrugë dhe trotuar, në , në afërsi të lokaleve afariste për 1 muaj	10
14.31	Leje për ndalje (ngarkim shkarkim) të mallrave në rrugë dhe trotuar, në , në afërsi të lokaleve afariste për 1 vit	50
14.32	Leje operimi për auto taxi 4+1 ulëse, për 1 vit	25
14.33	Leje operimi për kombi bus 8+1 ulëse (Leje e veqanet për transportin e nxënësve të mësimi fillor, atyre me nevoja të veqanta dhe personave që barten për hemodializ), për 1 vit	25
14.34	Ndërrimi i akvendimit për leje të operimit për auto-taxi (nënkuptohet kur nga pronari ndërrohet automjeti para skadimit të lejes që është pajisur më pare)	15
14.35	Vërtetimi i rendit të udhëtimit për linjën e rregullt të udhëtarëve dhe për transport të veqant, operatori transportues paguan taksën për një vit (për një relacion- nisje të caktuar)	15
14.36	Pëlqim për dhënjën lejes për vend-parkimin e automjeteve transportuse për mallra ,zhavor ,dru (Autoparku) /për një vit	150

	Leje për automjetet e renda transportuese me peshë prej (3.5-7.5)ton, të cilat kanë nevojë për qarkullim në ato rrugë(qendrës së qytetit) ku me shenjë të komunukacionit e kanë të ndalur	
14.37	Leje e lëshuar për 1 deri në 3 ditë	5
14.38	Leje e lëshuar për 1 deri në 15 ditë	15
14.39	Leje e lëshuar për 1 muaj	25
14.40	Leje e lëshuar vjetore të cilat rrugë shfrytëzohen here pas here	100

14.41. Taksat dhe ngarkesat për transport TAXI

- Transporti autotaxi i udhëtareve pa liqencë 500 €
- Operatoret taxi që nderprejn veprimtarin, dhe nuk e kthejn lejen e operimit 200 €
- Operatoret taxi që nuk i kan automjetet në gjendje sipas kushteve teknike 300 €
- Operatoret që nuk respektojn rendin e ardhjes dhe vozitjes ,.....200 €
- Autotaxi që nuk e vendosin lejen për ushtrimin e veprimtaris në menyre të dukshme... 100 €
- Autotaxit që bëjn bartjen :
 - Fëmijëve nën moshën 6 vjeqare pa pranin e prindit
 - Bartin kafshë të ngordhura
 - Kufoma
 - Material eksplozive(piroteknike) 500 €

Opertaori juridik që nuk I plotson kriteret :

- Nuk ka të regjistruar këtë lloj transporti
- Nuk është pronar I automjetet ose I autorizuar
- Nuk e ka selin e transportit ku vepron
- Nuk ka vendqendrimi per automjet 500 €

Parkingjet e rezervuara në hapsirën Publike- parkingje për një vit.

- Zona e pare 120 €

- Zona e dytë
60 €
 - Zona e tretë.....
30 €
- Parkingu kohor për një ditë**
- Zona e pare 1.00 €
 - Zona e dytë 0.50 €
 - Zona e tretë 0.30 €
- Nga kjo takes lirohën persona më aftësi të kufizuara dhe Shoqatat e luftës

14.42 Gjobat për demtimin ,shkatërrimin, gërvishtjen, prerjen, lakimin e :

E kamerave

Gjoba për personin juridik	500 € ,
Gjoba për personin fizik	300 €
Shenjat e komunikacionit	

Gjoba për personin juridik	100 € ,
Gjoba për personin fizik	50 €

Pritoret (kabinat) e stacioneve

Gjoba për personin juridik	60 € ,
Gjoba për personin fizik	30 € ,

14.43 Gjobat për keqpordorim të ujit të pishëm nga ujësjellësi (ujitja e oborrit etj)

- Personi fizik 50 Euro
- Përseni juridik 100 Euro

14.44 Gjobat për dëmtimin e vorrezave:

Për dëmtimin e lapidarve

- Përsenat fizikë.....200€
- Përsenat juridik..... 400€

14.45 Për dëmtim të pllakave përkujtimore të vorrezave

- Përsenat fizikë.....200€
- Përsenat juridik..... 400€

14.46 Për zjarrvënje të qëllimshme në sipërfaqet e vorrezave,

- Përsnat fizikë.....100€
- Përsnat juridik..... 200€

14.47 Ndërsa për gjobat për dispozitat ndeshkimore për masat mbrojtse kundër zjarrit duhet respektuar Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri nr. 04/L-012, përkatësisht kreun e VII, nenet, 34,35 dhe 36

14.48 Taksat për dhënjën më qira të tregut të gjelbert (sipërfaqje e përgjithshme e tregut)

Zona I.....	1.0 €/m ² për vit
Zona II	0.70 €/m ² për vit
Zona III.....	0.5 €/m ² për vit

Kafshve

Zona I.....	0.50 €/m ² për vit
Zona II	0.30 €/m ² për vit
Zona III.....	0.20 €/m ² për vit

14.49 Taksat për hyrje në tregun e Gjelbert.

Për kamion 3.5 t	5 € në ditë
Për kamion 5t	7 € në ditë
Për kamion 7.5 t	8 € në ditë

14.50 Taksat për hyrje në tregun e Kafshve

3 €, për copë në ditë për kafsh të trasha në ditë dhe
0.50 € për kafsh të imta në ditë

**14.51 PËR HAPËSIRËN NË TË CILËN VENDOSËN REKLAMAT, PANOTË,
KOMPENZIMI PAGUHET ME SA VIJON:**

- Për reklama, pano ndriçuese që tregojnë ku është vendosur lokali

afarist, ngarkesa për një vit është	50 € m ²
- Për reklama, pano pa ndriçim dhe lajmërimi që tregojnë vendin ku është vendosur lokali afarist, ngarkesa për një vit është.....	25 € m ²
- Për hapësirën që shfrytëzohet për lojërat e cirkut, lojërave argëtuese etj. ngarkesa është ditore edhe është.....	0.50 € m ²
- Toka që shfrytëzohet për të vendosur të gjitha llojet e aparateve, (akulllore) për aparat në vitë	
Zona I	70 €
Zona II	30 €
Zona III	10 €

14.52 Veprimtarit për të cilat kërkohet leje mjedisore komunale (UA MMPH 01/2017)

Të gjitha veprimtarit për të cilat kërkohet Leje mjedisore komunale janë në shtojcën 1 të këtij udhëzimi.

Tarifa për tu paisur me leje Mjedisore komunale paguhet taksa:

- Në vlerën investive të projektit deri në shumën 25,000 euro paguhet tarifa në vlerë prej: 50 €
- Në vlerën e investive të projektit mbi 25,000 euro paguhet tarifa 0.2% të vlerës investive të projektit.

Të liruara nga pagesa e kësaj tarife janë projektet publike.

Neni 15

15.2. Ngarkesa për lejen e pronësisë së automjetit ,parkimin dhe tërheqjen e automjetit

Të gjithë banorët dhe bizneset, kerkohet të marrin leje për pronësin e automjetit Brenda kufijve të Komunës së Drenasit.

Për sigurimin e këtyre lejeve për automjete të bizneseve apo banorëve duhet të sigurohën dëshmi mbi regjistrimin e automjetit nga autoriteti qendror i Kosovës dhe adresën e shtëpisë ose selinë e biznesit të regjistruar pranë MTI-së.

Tarifat për lëshimin e lejës do të paguhën në Komunë në bazë vjetore.

Këto tarifa do të jenë si vijon:

a).Për automjete dhe taksi :

Benzinë – naftë

Deri në 3000 ccm	10 €
Nga 3000 – 3500 ccm	20 €
Mbi 3501	30 €

b).Për Kamion që bëjnë transportin e mallrave:

Benzinë – naftë

Deri në 3.5 t	15 €
Mbi 3.5 t	30 €

c) Për autobus

Për autobusë	30 €
--------------	------

15.3 Nga tarifa për leje për mjete motorike lirohë të gjitha automjetet e KFOR-it, UNMIK-it, EULEX-it përfaqësive diplomatike, emergjencës (makinat e zjarrfikseve dhe ato të ndihmës së shpejt). Provë për këtë është leja e qarkullimit të automjetit.

Për aplikimin e kësaj pjese të tarifave përgjegjëse është Drejtorati për Buxhet dhe financa.

Neni 16

Tarifa e shërbimeve kadastrale komunale të përcaktuara janë të harmonizuara me Udhzimin Administrativ MMPH nr. 05/2012

Tarifat e rekomanduara nga Agjencia Kadastrale e Kosovës do të jenë të aplikueshme.

Ndërrimi i kulturave të parcelave:

Ndërrimii kultures të një parcele pa matje gjeodezike	10 €
---	------

Ndërrimi i kultures të një parcele me matje bëhet sipas tarifave të përcaktuara në paragrafin 2 të kësaj rregullore.	
--	--

16.1.Ndarja e parcelave:

Ndarja e një parcele në dy pjesë sipas gjendjes faktike në teren deri në 0.50ha	75 €
Për çdo ndarje në pjesë tjetër	25 €
Ndarja e një parcele në dy pjesë sipas gjendjes faktike në terren në sipërfaqe 0.50ha-1.0ha	100 €
Ndarja e një parcele në dy pjesë sipas gjendjes faktike në terren në sipërfaqe 1.0ha - 5.0ha	150 €
Ndarja e parcelës në pjesë të përcaktuara më par,në sipërfaqe deri në 0.50 ha	80 €
Ndarja në më tepër se dy pjesë të përcaktuara më par,për çdo pjesë	40 €
Ndarja e komplekseve me sipërfaqe prej 5 – 10 ha në dy pjesë	200 €
Për çdo ndarje në pjesë tjetër	100 €
Ndarja e komplekseve me sipërfaqe mbi 10 ha në dy pjesë	500 €
Për çdo ndarje në pjesë tjetër	200 €
Për ndarjet e sipërfaqev me kulturë mal çmimi rritet për 30%	
Për ndarjet e sipërfaqeve jasht sezoni (15 nëntor-15 mars) në teren çmimi rritet për 25%	

16.2.Bashkimi I parcelave

Bashkimi I dy parcelave pa matje	20 €
Për çdo parcel tjetër në kufi	10 €

16.3.Matja e ndertesave:

Matja për një ndertesë individuale për një m ² të bazës gjeodezike	0.50 €
Çdo ndertesë tjetër në të njëjtën parcelë për një m ² të bazës gjeodezike	0.25 €
Ndertesë banimi kolektiv për një m ²	0.50 €
Çdo ndertesë tjetër në të njëjtë parcelë për një m ²	0.50 €
Ndertesë afariste për një m ²	0.70 €
Çdo ndertesë tjetër në të njëjtë parcelë për një m ²	0.70 €
Ndertesë banesore – afariste për një m ²	0.70 €
Për çdo ndertesë tjetër në të njëjtë parcelë për një m ²	0.50 €
Ndertesë e administratës qeveritare dhe publike për një m ²	0.50 €
Për çdo ndertesë tjetër në të njëjtë parcelë për një m ²	0.50 €
Objekte për sport dhe rekreacion (stadium,hallasportive etj) për një m ²	0.50 €
Objekte kulturore dhe fetare për një m ²	0.30 €
Për çdo ndertesë tjetër në të njëjtën parcelë për një m ²	0.20 €

16.4. Matjet e pjesëve të ndërtesave:

Hapësirat banesore dhe përpilimi I skicës së katit të ndërtesës për një m ²	0.80 €
Kati me skicat e njësive të veqanta për një m ²	0.70 €
Hapsirat afarsite dhe përpilimi I skicës për një m ²	1 €
Ndarja e hapsirave banesore dhe përpilimi I skicës – për çdo pjesë për një m ²	0.75 €
Ndarja e hapsirave afariste dhe përpilimi I skicës – për çdo pjesë për një m ²	0.75 €

16.5. Matjet e përçojave:

Përçoja nëntoksore për meter gjatësi	0.50 €
Përçoja mbi toksore për meter gjatësi	0.25 €
Objektet nëntokësore (objektet deri në 100 m ² paguajn 100 € mbi 100 m ² për çdo m ² edhe 2 €)	100 €
Objektet nëntokësore mbi 100 m ² paguajn për çdo m ² edhe 2 €)	
Për çdo objekt tjetër	50 €
Tunelet për meter gjatësi	5 €

16.6. Përcaktimi I kufijve të parcelave:

Për çdo parcel me sipërfaqe gjerë 0.50 ha	80 €
Për sipërfaqe prej 0.50 ha deri në 1.00 ha	100 €
Për çdo hektar tjetër mbi një (1) hektar	60 €
Për parcelat urbane sipas planit urbanistik (pas marrjes së pelqimit nga D.e Urbanizmit)	120 €
Për parcelat me kulture pyjore pagesa rritet për 30%	

16.7. Rregullimi I kufijve të parcelave:

Për një parcelë me sipërfaqe gjerë 0.50 ha	40 €
Për sipërfaqe prej 0.50 ha e deri në 1.00 ha	50 €
Për çdo hektar tjetër mbi një (1) hektar	30 €

16.8. Dhënja e deshmive nga baza e të dhënave kadastrale tekstuale apo grafike sipas kërkesës së pales nga ZKK:

Dhënja e vërtetimeve të ndryshëm	3 €
Certifikata mbi pronën	4 €
Kopja e planit për një parcelë	5 €
Për çdo parcelë tjetër	2 €
Kopja e hartës kadastrale AO letër e thjeshtë, horizontal (1:500, 1:1000, 1:2500, 1:5000)	20 €
Historiku për një parcelë	30 €

16.9.Punët e zyrës sipas kërkesës se palëve pa matje:

Identifikimi I njësive kadastrale në terren- për njësi kadastrale	20 €
Për çdo njësi tjetër në kufi	5 €
Kontrollimi dhe regjistrimi në regjistër I të dhënave nga terreni për njësi të kadastrave	20 €

16.10.Punët e veçanta gjeodezike:

Bartja në terren e të dhënave nga planet urbanistike për objektet individuale për m ²	0.50 €
Bartja në terren e të dhënave nga planet urbanistike për objektet banimit kolektiv apo afarist për m ²	0.50 €

Baza gjeodezike:

Pikat trigonometrike:	
Koordinatat Y,X me përshkrim	5 €
Pikat lidhëse:	
Koordinatat Y,X me përshkrim	4 €
Pika poligonale:	
Koordinatat Y,X,Z , me përshkrim	3 €
Pikë reper :	
Koordinatat Y,X,Z , me përshkrim	5 €
Pikat në Linjë:	
Koordinatat Y,X,Z	2 €
Pikat e detajit:	
Koordinatat Y,X	1 €
Vendosja e pikave trigonometrike	50 €

Transporti për vajtje ardhje nga terreni për gjeodetet bie në barren e organit , derisa të rregullohet më aktë të veçant.

16.11.Lirohën nga pagesa e tarifës për vërtetime dhe certifikata të pronësisë rastet sociale;

16.12. Për t'u liruar nga pagesa nevojitet dëshmia (kartoni) nga qendra për punë sociale.

Tarifat e shërbimeve për regjistrimin e të drejtave të pronës së palujtshme të përcaktuara më udhëzimin e Ministris së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinore nr. 08/2014.

Regjistrimi I pronësisë,shfrytëzimit,në bazë të transakcioneve (shitblerjës)

16.13.Regjistrimi I pronësisë,shfrytëzimit sipas transakcioneve do të bëhet sipas vlerave të transakcioneve të kryera për pronën e palujtshme:

16.14	Për vlerën e transakcionit deri në 10,000 € paguhet taksa prej	20 €
-------	--	------

16.15	Për vlerën e transakcionit prej 10,000 € - 30,000 € paguhet taksa prej	30 €
16.16	Për vlerën e transakcionit prej 30,000 € - 50,000 € paguhet taksa prej	35 €
16.17	Për vlerën e transakcionit prej 50,000 € - 100,000 € paguhet taksa prej	50 €
